



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166, DATË 16.12.2004 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 75 pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 13, pikat 3, 4, 5 dhe 6 ndryshojnë si më poshtë:

“3. Këshilli shqyrton kërkesën e prokurorisë për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin, heqjen e lirisë në çfarëdo lloj forme, ushtrimin e kontrollit personal apo të banesës së një deputeti. Procedura e detajuar parashikohet në nenet 118 dhe 119 të kësaj Rregulloreje.

4. Këshilli shqyrton të gjitha çështjet e vlefshmërisë së mandatit të deputetit që lidhen me fillimin dhe mbarimin e ushtrimit të mandatit, heqjen dorë nga mandati, kushtet e papajtueshmërisë, sipas nenit 70 të Kushtetutës, mungesën pa arsye për më shumë se 6 muaj rresht në Kuvend, dënimin me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Pas përfundimit të shqyrtimit, Këshilli paraqet raportin përkatës në seancë plenare brenda 2 javëve.

5. Këshilli shqyrton rastet e pazgjedhshmërisë, sipas nenit 69 të Kushtetutës si dhe bën verifikimin e mandatit të deputetit, i cili zgjidhet gjatë legjislaturës kur krijohet vakancë, mbi bazën e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pas përfundimit të shqyrtimit, Këshilli paraqet raportin përkatës në seancë plenare brenda 2 javëve.

6. Këshilli, si rregull, mbledhet në mënyrën e parashikuar nga kjo Rregullore për komisionet e përhershme, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

Neni 2

Në nenin 14, shtohet pika 2/1 dhe pikat 3-6 ndryshohen si vijon:

“2/1. Këshilli analizon vendimet e Gjykatës Kushtetuese për kushtetutshmërinë e legjislacionit që ka nismëtarë anëtarët e Kuvendit, për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës, kur Kuvendi është palë, për shkarkimin e funksionarëve kushtetues, të cilët zgjidhen nga Kuvendi, si dhe për rastet kur kërkohet nga jo më pak se 1/5 e deputetëve. Procedura e detajuar parashikohet në nenin 87 të kësaj Rregulloreje.

3. Këshilli, me kërkesën e komisionit përgjegjës ose të Kryetarit të Kuvendit, shpreh mendimin e tij për pajtueshmërinë me Kushtetutën dhe me kuadrin ligjor që ka lidhje me të për një projektligj që komisioni përgjegjës ose Kryetari i Kuvendit i konsiderojnë të rëndësishme.

4. Komisioni përgjegjës, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij, ose Kryetari i Kuvendit mund të kërkojnë mendimin e Këshillit për Legjislacionin. Kërkesa duhet të parashikojë një kohë të arsyeshme shqyrtimi për Këshillin. Në përputhje me kalendarin e punimeve të komisionit përgjegjës dhe të harmonizohet me kalendarin e punimeve të Kuvendit. Në mbledhjen e Këshillit merr pjesë relatori i komisionit përgjegjës dhe propozuesi i projektligjit.

5. Raporti i Këshillit për Legjislacionin i përcillet komisionit përgjegjës brenda 3 ditëve. Nëse komisioni përgjegjës nuk merr parasysht mendimin e Këshillit, ai paraqet edhe arsyetimin përkatës në raportin për seancën plenare.

6. Këshilli, si rregull, mbledhet në mënyrën e parashikuar nga kjo Rregullore për komisionet e përhershme, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

Neni 3

Pas nenit 27, shtohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 27/1

Rendi i ditës i seancës plenare

1. Rendi i ditës i seancës plenare përmban çështjet që janë parashikuar në kalendarin 3 javor të punimeve të Kuvendit dhe që kanë përfunduar shqyrtimin në komisionet parlamentare.

2. Për çështje të tjera, të parashikuara në këtë Rregullore, por që nuk janë pjesë e kalendarit, Kryetari i Kuvendit dhe/ose Konferenca e Kryetarëve miratojnë një rend dite të veçantë.

3. Rendi i ditës miratohet me urdhër të Kryetarit të Kuvendit dhe bëhet publik të paktën 2 ditë përpara datës së caktuar për seancën plenare.”

Neni 4

Në nenin 55, pika 1 ndryshon si më poshtë:

1. Kuvendi miraton ligje, vendime, rezoluta dhe deklarata.
2. Kuorumi për çeljen e seancës së votimit parlamentar është minimalisht 71 deputetë.
3. Aktet e Kuvendit konsiderohen të miratuara kur për to ka votuar "pro" shumica e deputetëve.
4. Për përcaktimin e kuoromit dhe të shumicës së deputetëve, Kryetari i Kuvendit i referohet vetëm numrit të deputetëve që kanë votuar.
5. Aktet për të cilat kërkohet shumicë e cilësuar për miratim, kërkojnë minimalisht kuorumin e cilësuar, sipas parashikimit në Kushtetutë apo në ligj.
6. Drejtuesi i seancës plenare, në leximin e rendit të ditës, i njofton Kuvendit edhe shumicën që kërkon votimi i çdo çështjeje të saj.

Neni 5

Në nenin 60, pika 1/1 shfuqizohet.

Neni 6

Neni 87 ndryshon si më poshtë:

1. Kryetari i Kuvendit ia përcjell Këshillit për Legjislacionin vendimet e Gjykatës Kushtetuese për:
 - a) kushtetutshmërinë e legjislacionit që ka nismëtarë anëtarët e Kuvendit;
 - b) interpretimin përfundimtar të Kushtetutës;
 - c) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës, kur Kuvendi është palë;
 - ç) shkarkimin e funksionarëve kushtetues, të cilët zgjidhen nga Kuvendi;
 - d) rastet kur kërkohet nga jo më pak se 1/5 e deputetëve.
2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese për legjislacionin, merren në shqyrtim nga Këshilli për Legjislacionin 30 ditë pas botimit të tyre në Fletoren Zyrtare.
3. Këshilli analizon dhe diskuton, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Rregullore, efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, sipas pikës 1 të këtij neni. Në përfundim, Këshilli harton një raport dhe ia paraqet Kryetarit të Kuvendit.
4. Raporti i Këshillit, kur çmohet e nevojshme, mund t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, Këshillit të Ministrave dhe Presidentit të Republikës.
5. Kur nevojitet marrja e nismës ligjvënëse për plotësime ose ndryshime në legjislacion, Këshilli i paraqet rekomandimet e nevojshme komisionit përgjegjës dhe nismëtarit, ose ndërmerr vetë nismën ligjvënëse.

Neni 7

Neni 118 riformulohet si vijon:

Neni 118

Autorizimi për procedim

1. Kërkesa për të autorizuar caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, kontrollit personal ose të banesës, i paraqitet Kryetarit të Kuvendit nga Prokurori. Kërkesa përmban një relacion të arsyetuar dhe të shoqëruar me provat që mbështesin kërkesën.
2. Kryetari i Kuvendit ia dërgon kërkesën dhe dokumentet shoqëruese menjëherë për shqyrtim Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin si dhe vë në dijeni Kuvendin dhe deputetin.
3. Kryetari i Kuvendit, pas konsultimit me Këshillin, cakton dy relatorë për çështjen, respektivisht nga shumica dhe opozita parlamentare.
4. Deputetit, ndaj të cilit kërkohet autorizimi për procedim, i vihet në dispozicion kërkesa dhe dokumentet që e shoqërojnë atë, si dhe i bëhet e ditur koha kur Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin do të fillojë shqyrtimin e kërkesës.
5. Në mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin merr fjalën Prokurori, i cili paraqet arsyet e kërkesës drejtuar Kuvendit. Pas paraqitjes së kërkesës, çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë t'i drejtojë pyetje Prokurorit.
6. Pas përgjigjeve të pyetjeve, Kryetari i Kuvendit, i jep fjalën deputetit ndaj të cilit kërkohet autorizimi për procedim. Deputeti dhe ose përfaqësuesi i tij ligjor, ka të drejtë të paraqesë në Këshill, me shkrim ose me gojë, shpjegimet dhe vërejtjet e tij rreth çështjes. Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë t'i drejtojë pyetje deputetit.
7. Shqyrtimi i çështjes në Këshill, kryhet nëpërmjet një procedure që i garanton deputetit, ndaj të cilit kërkohet autorizimi për procedim, të drejtën për t'u informuar në kohë, për t'u pyetur, për t'u dëgjuar dhe për të bërë pyetje ndaj kërkuesve të autorizimit si dhe për të paraqitur shpjegimet e tij.
8. Përpara diskutimit të çështjes Kryetari i Kuvendit fton dy relatorët të paraqesin vlerësimin e përgjithshëm mbi çështjen që shqyrtohet. Më pas vijohet me diskutimin në Këshill. Në përfundim të diskutimit, Këshilli, brenda një jave, harton raportin për në seancë plenare. Raporti rekomandon miratimin ose rrëzimin e kërkesës për dhënie autorizimi për procedim. Raporti i Këshillit u shpërndahet menjëherë deputetëve dhe bëhet publik.
9. Si rregull, mbledhja e Këshillit, për pikat 6-8 të këtij neni, zhvillohet me dyer të hapura. Këshilli, për arsye të mbrojtjes së të dhënave, mund të zhvillojë diskutimin me dyer të mbyllura.
10. Shqyrtimi i kërkesës për dhënien e autorizimit për procedim parashikohet për shqyrtim në seancë plenare jo më parë se një javë, por jo më vonë se dy javë nga paraqitja e raportit të Këshillit.

11. Në seancë plenare fjala i jepet në fillim deputetit, ndaj të cilit është paraqitur kërkesa, për të dhënë shpjegime ose për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve. Koha e debatit, kur çmohet e nevojshme, përcaktohet nga Konferenca e Kryetarëve, në përputhje me nenin 48 të kësaj Rregulloreje. Në përfundim të debatit, pas ljalës së kryetarëve të grupeve parlamentare, ka të drejtë të flasë deputeti ndaj të cilit kërkohet dhënia e autorizimit për procedim për jo më shumë se 10 minuta.

12. Kuvendi në seancë plenare, për arsye të mbrojtjes së të dhënave, mund të zhvillojë diskutimin me dyer të mbyllura.

13. Kuvendi vendos me votim të hapur për miratimin ose rrëzimin e kërkesës për dhënie autorizimi për procedim.

14. Në rastin kur Kuvendi nuk merr vendim për dhënien ose mosdhënien e autorizimit për procedim brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës përkatëse, atëherë kërkesa konsiderohet e rrëzuar nga Kuvendi.

15. Përcaktimet e bëra në këtë nen zbatohen edhe në rastet e dhënies së autorizimit për procedim për anëtarin e Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Neni 119 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 119

Procedura në rastin kur deputeti është ndaluar ose arrestuar

1. Në rastin kur një deputet është ndaluar ose arrestuar, pa autorizim, në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë, zbatohen parashikimet e pikave 2-9 dhe 11-13 të nenit 118 të kësaj Rregulloreje.

2. Këshilli, brenda 24 orëve nga njoftimi i Kryetarit të Kuvendit, shqyrton nëse ka vend për procedim ndaj deputetit të arrestuar ose të ndaluar dhe harton raportin.

3. Kryetari i Kuvendit brenda 24 orëve nga paraqitja e raportit thërret seancën plenare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI

RELACION SHOQËRUES

PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166, DATË 16.12.2004 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

Kuvendi i Shqipërisë organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij. Në Rregulloren e Kuvendit gjejnë pasqyrim në mënyrë të detajuar edhe dispozita të Kushtetutës, dokumentit themeltar të shtetit, transpozimi i të cilave duhet që të reflektojnë në kohë edhe ndryshimet kushtetuese të herëpashershme.

Në kushtet kur Kushtetuta ka pësuar ndryshime, në mënyrë të veçantë kufizimi i imunitetit për deputetët, ndryshimet e reformës në sistemin e drejtësisë, përbën domosdoshmëri reflektimi i tyre edhe në Rregulloren e Kuvendit.

Krahas reflektimit të ndryshimeve kushtetuese, domosdoshmëri për Kuvendin përbën edhe zbatimin i vendimeve të gjykatës Kushtetuese dhe jurisprudencës së saj.

Për sa më lart, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, propozon këto ndryshime të Rregullores së Kuvendit për të bërë përputhjen e saj të plotë me dispozitat e Kushtetutës dhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

Ndryshimet e propozuara synojnë të përmirësojnë ndjeshëm dispozitat e Rregullores së Kuvendit, në mënyrë të posaçme nenet 13, 118 dhe 119, të cilat e referohen ndryshimeve kushtetuese të vitit 2012 dhe 2016 që kanë të bëjnë me kufizimin e imunitetit të deputetit. Ndërsa në nenet e tjera janë propozuar ndryshime me qëllim për të bërë saktësimin e tyre sipas neneve të Kushtetutës dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste vlerëson se Rregullorja e Kuvendit duhet t'i nënshtrohet një procesi të plotë reformimi, me qëllim sjelljen e saj në përputhje me standardet më të larta të demokracisë parlamentare dhe modeleve më të përparuara ndërkombëtare, në bashkëpunim me të gjitha forcat politike që përfaqësohen në Kuvend.

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste shpreh se këto ndryshime janë në përputhje me Kushtetutën dhe dispozitat e tjera të Rregullores së Kuvendit dhe kërkon shqyrtimin dhe miratimin e tyre në Kuvend për ta sjellë Rregulloren sa më parë në parametra kushtetuese.

